



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 04.11.2025

Numër Protokolli: 7168/2025

A.nr.1813/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Flakron Gashi- në cilësinë e procesmbajtësit ka shqyrtuar ankesën A.nr.1813/2025, të datës 17.10.2025, të parashtruar nga ankuesi T.P, nga Mitrovica, kundër Njoftimit të datës 17.10.2025 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Leposaviqit, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 04.11.2025 mori:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa A.nr.1813/2025, e datës 17.10.2025 e parashtruar nga ankuesi T.P.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbimin civil, T.P (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi*), me datë 17.10.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar me numër protokolli 6860/2025 nën shenjën A.nr.1813/2025, kundër Njoftimit të datës 17.10.2025 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Leposaviqit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 17.10.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë te Komuna e Leposaviqit, ndërsa kjo e fundit me datë 29.10.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë lidhur me procedurën në fjalë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit*) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën të datës 17.10.2025 të parashtruar nga ankuesi në KPMSHCK; Njoftimin e datës 17.10.2025 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Leposaviqit; Kopjen e letërnjoftimit të ankueses; Njoftimin Nr.283/2025 e datës 17.10.2025 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Leposaviqit; E-mailin e datës 17.10.2025 e dërguar nga ankuesi

për Këshillin; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 23.10.2025; Përgjigjen e datës 29.10.2025 me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji i Këshillit, pas analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit në këtë fazë **është e palejuar, sepse:**

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka konstatuar se Komuna e Leposaviqit, më datë 06.10.2025 ka shpallë konkursin me numër Reference RN00018818, për Grupi i Shkencave Shoqërore, pozita e punës *“Zyrtar për Integrime Evropiane”*, Zyra për Komunitete dhe Kthim në Komunën e Leposaviqit, ku afati për aplikim ka qenë nga data 07.10.2025 deri më 13.10.2025, ndërsa nga shkresat e lëndës arrihet në konstatimin se edhe ankuesi ka aplikuar në këtë konkurs.

Tutje, nga shkresat e lëndës rezulton se ankuesi, nuk e ka kaluar fazën e verifikimit paraprak, pasi që Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Leposaviqit, përmes Njoftimit të datës 17.10.2025 i ka refuzuar aplikacionin me arsyetimin se i njëjti nuk plotëson kriteret e përgjithshme të konkursit, ndërlidhur me përvojën e punës e cila nuk është mbështetur me dokumente përkatëse sipas kërkesave në konkurs.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill, pretendon se i është refuzuar aplikacioni në mënyrë të kundërligjshëm për procedurën e rekrutimit sipas konkursit përkatës, pasi që i kam plotësuar kriteret e nevojshme të kualifikimit dhe të përvojës së punës, me kërkesën që Këshilli të aprovoi ankesën e tij ndërsa lëndën ta kthejë për vlerësim të serishëm në fazën e verifikimit paraprak.

Kolegji i Këshillit lidhur me këtë çështje juridike administrative, sa i përket procedurave të pranimit lidhur me pranueshmërinë e ankesës së ankueses mori për bazë dispozitat e nenit 27 Paragrafi 4 të Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik , i cili përcakton se: *“4. E drejta e ankimimit në KPMSHCK i njihet edhe çdo kandidateje/i në procedurë pranimi në shërbimin civil”*, si rrjedhojë meqenëse ankuesi konteston procedurën e rekrutimit që ndërlidhet me fazën e verifikimit paraprak, atëherë Kolegji i Këshilli konstaton se mënyra e parashtrimit të ankesës lidhur me procedurat e pranimit në Shërbimin Civil është rregulluar me nenin 44 paragrafi 10 të Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik i cili përcakton se: *“10. Kandidatet/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative.”*, dhe me nenin 17 Rregullore Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit Në Shërbimin Civil, është përcaktuar se: *“Kandidatët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK në afat prej tridhjetë (30) ditëve”*.

Kolegji i Këshillit duke marrë parasysh provat e lëndës si dhe duke ju referuara dispozitave të cekura si me lart konstaton se ankuesi ankesën e datës 17.10.2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil e ka parashtruar para shpalljes së rezultateve përfundimtare, gjegjësisht Kolegji konstaton se meqë procedura e ankesës ndaj procedurës së pranimit është parashikuar sipas dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe Rregullores (QRK) nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil,

atëherë ankesa e parashtruar para shpalljes së rezultateve përfundimtare është në kundërshtim me nenin 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ngase refuzimi i aplikacionit të ankuesit nuk nënkupton shpalljen e rezultateve përfundimtare në kuptim të nenit 17 të Rregullores Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, pasi që procedura e rekrutimit në rastin e konkursit ndaj të cilit ankuesi ka parashtruar ankesë ende nuk kishte përfunduar në kuptim të nenit 44 paragrafi 10 të Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik.

Bazuar si me sipër si dhe duke ju referuar provave të lëndës Kolegji i Këshillit konstaton se ankesa e ankuesit e datës 17.10.2025 e parashtruar ne Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil, është e pa lejueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative sepse e njëjta është parashtruar në fazat fillestare të procedurës së rekrutimit gjatë të cilave ligji material nuk e ka përcaktuar të drejtën e ankesës në KPMSHCK.

Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1813/2025, datë 04/11/2025.

Flakron GASHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit T.P;
- Komunës së Leposaviqit (Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore), si dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.